



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.845/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Burim Ademi dhe Afijete Sada Gillogjani anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelet e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Xhevdet Maloku nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhen të palejuara apelet Anr.845/2021, Anr.846/2021, dhe Anr.847/2021 të gjitha të datës 04.11.2021, parashtruar nga Xhevdet Maloku nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

A r s y e t i m

Me datë 04.11.2021, PZAP-i ka pranuar apelet Anr.845/2021, Anr.846/2021, dhe Anr.847/2021 të parashtruar nga Xhevdet Maloku nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Komunën e Podujevës, me të cilën thekson se sipas dyshimit të bazuar në fakte në FPR subjekti politik Vetëvendosje përkatësisht bartësi i listës Florent Hasani i ka gjithsej 185 vota, ndërsa kandidatet e këtij subjekti kanë ,kë shumë vota 188, pra tri më shumë sesa bartësi. Si dëshmi ka paraqitur FPR- në.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apelet janë të palejuara

Paneli duke vepruar konform Rregullës Nr. 02/2015 Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, përkatësisht në bazë të nenit 13.2 *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të apeleve, kryesuesi i panelit vendim marrës mund të vendosë ta bëjë bashkimin e apeleve që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim”* ka bashkuar apelet

Anr.845/2021, Anr.846/2021, dhe Anr.847/2021 të gjitha të datës 04.11.2021, duke i trajtuar si një apel i evidentuar Anr.845/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve për apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim, i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se apelet e parashtruara nga Xhevdet Maloku nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Komunën e Podujevës, kanë njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me apelin e parashtruara po nga i njëjti kandidat të paraqitur me datën 04.11.2021, për të cilin janë vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.848/2021 të datës 05.11.2021.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton fakti se apelet e parashtruara nga Xhevdet Maloku nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Komunën e Podujevës është çështje e gjykuar “res iudicata”.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.848/2021 të datës 05.11.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.845/2021 më datën 06.11.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.